



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA JURIDIKE
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ prot.

Vlorë, më ____ . ____ .2025

PROCESVERBAL-Tipi i kontratës - Punë

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E
SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR
KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është përefekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “KUB Vlorë (Kanalizimet e Ujrave të Bardha) – Rindërtimi, ridimensionimi dhe rehabilitimi i kolektorëve kryesorë përgjatë rrugës Transballkanike, sipas loteve: nga rruga e Skelës deri te rruga Hasan Kushta (Albano dhe Romina), rruga Odise Grillo, si dhe kolektori nga dalja e rrugës Transballkanike deri në shkarkimin në Kanalin e Fushës.”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

45232410-9 - Punime në kanalizime, 45210000-2 - Punime ndërtimi,

VLERA E FONDIT LIMIT: 232,867,500.00 (dyqind e tridhjetë e dy milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: *"Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik"*.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertës", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik"

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve në Shtojcën 7 të DST

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar të nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t'i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e

vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 date 28.12.1998 "Për tatimin mbi te ardhurat", i ndryshuar, neni 29.

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet, të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

"Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020 date 23.12.2020 "Për prokurimin publik", neni 76 për kriteret detyruese për skualifikim, si dhe Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

2.2.3 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore të 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të çertifikuara nga organet tatimore si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabel ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabel, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës

kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumë prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumë prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 49 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: 114,105,075.00 (njëqind e katërmëdhjetë milion e njëqind e pesë mijë e shtatëdhjetë e pesë) lek pa TVSH dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht : 465,735,000.00 (katërqind e gjashtëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tridhjetë e pesë mijë) lek pa TVSH.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me :
- Kontratë sipërmarrje;
- Situacion përfundimtar;
- Faturat tatimore për këtë situacion të deklaruar në organet tatimore;
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar.

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë sipërmarrje;
- Situacion përfundimtar;
- Faturat tatimore për këtë situacion të deklaruar në organet tatimore;
- Akt kolaudimi objekti.

Në rastin e bashkimit të operatorëve pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët Ekonomikë, anëtar të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

- **Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.**
- **Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e Autoritetit Kontraktor.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 49 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë 5 (pesë) viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Për kontratat e realizuara si bashkim operatorësh, operatorit ekonomik ofertues i është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE – së, mbështetur në parashikimet e nenit 88 të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni AK ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor është kërkuar edhe miratimi nga ana e autoritetit kontraktor, si nënkontraktor i deklaruar, në respektim të parashikimeve të nenit 89 të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Pra, dokumentacioni i kërkuar si më sipër, është kërkuar me qëllim që AK të përllogarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3.1, shkronja a) dhe b).

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e

Infrastrukturës dhe Energjisë në bazë të VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

NP – 1 B Punime gjërmimi në tokë

NP – 4 A Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, dhe pista aeroportuale

NP-5 A- Punime nentokesore, ura dhe vepra arti

NP- 12A Punime të inxhinierisë mjedisore

Për punimet speciale të ndërtimit :

NS-8 D -Nderime betonarme parafabrikat, struktura metalike

NS-9 B -Punime strukturore speciale

NS – 18 A Punime topogjeodezike

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësimin e licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008 ”Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8 402, datë 10.09.1998 ”Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, ku neni 8 përcakton ”Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimi. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomikë të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko – profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria	Pershkrimi i kategorisë	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gërmimi në tokë.	Referuar kapitullit të gërmimeve sipas parashikimit të projekt preventiv	B	21-50 milion
NP-4	Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale	Referuar gjithë punimeve në rrugë.	A	0-20 milion
NP-5	Punime nëntokësore, ura e vepra arti	Referuar Punimeve të veprave të artit, punimet e beton armese sipas parashikimit në projekt preventiv	A	0-20 milion
NP- 12	Punime të inxhinierisë mjedisore	Referuar punimeve të inxhinierisë së mjedisit, Përfshin gjithë punimet në rrugë.	A	0-20 milion
NS-8	Ndertime betonarme parafabrikat, struktura metalike	Referuar në preventiv – Punime Betoni dhe Betonarmeje, Punime Hekur Betoni	D	101-200 mln
NS-9	Punime strukturore speciale	Referuar në preventiv – Palankola për mbrojtjen e skarpatave etj	B	21-50 mln
NS-18	Punime topogjeodezike	Konsiderohet zbatimi i rëlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.	A	0-20 milion

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- **1 (një) Inxhinier Gjeodet/ Topograf /Markshajder**
- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi**
- **1 (një) Inxhinier Hidroteknik**
- **1(një) Inxhinier Gjeoteknik**
- **1(një) Inxhinier Mjedisi**

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin tjetër inxhinierik** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Hidrogeolog 1 (një)

Për stafin e mësipërm inxhinierik Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të*

kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune, diplomë universitare, librezë pune dhe CV

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar përsa i takon ndalimeve të dypunësimit. Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin”.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Ing. Ndërtimi** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht zërave të punimeve që klasifikohen në kategoritë përkatëse.
- **Ing. Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve elektrike, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht zërave të punimeve që klasifikohen në kategoritë përkatëse.
- **Ing. Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e punimeve. Është kërkuar Inxhinier Elektrik, pasi shoqëria jep informacionin e duhur për aktivitetin që është menduar të kryhet në përputhje me faktin se punimet kryhen në rrugë ekzistuese në prezencë të kabllove nentokesore elektrike, telefoni, interneti etj., si dhe për zhvillimin e aktivitetit që do të jetë në përputhje me kriteret për të mos shkaktuar demtime gjatë zbatimit dhe zhvillimin e aktivitetit nevojitet eksperiencia profesionale e Inxhinierit Elektrike.

AK argumenton se kërkesa për inxhinierin elektrike është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

- **Inxhinieri Topograf/Gjeodet/Markshajder** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në licencën profesionale të shoqërisë.
 - **Ing. Gjeoteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve gjeoteknike, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht zërave të punimeve që klasifikohen në kategoritë
 - **Ing. Hidrogjeolog** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve hidrogjeologjike, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht zërave të punimeve që klasifikohen në kategoritë përkatëse.
 - **Ing. Mjedisi** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve mjedisore duke pasur punime për rehabilitim skarpatah, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht zërave të punimeve që klasifikohen në kategoritë përkatëse.
- Operatori ekonomik pjesëmarrës, në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, duhet të përcaktojë me anë të një **deklarate** (nënshkruar nga Administratori i Shoqërisë), **Drejtuesin Teknik të punimeve** (inxhinier me eksperiencë) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërise dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- **2 (dy) Teknik Ndërtimi** të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.
- **4 (manovratorë) manovratorë** të specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin dëshmi nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, kontratë individuale pune. (në rastin kur punonjësit Manovrator janë të kontraktuar me kontratë pune, respektivisht për mjetet e marra me qera, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.)
- **4 (katër) shofer kamioni** të pajisur me lejen e drejtimit përkatëse, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, kontratë individuale pune. (në rastin kur punonjësit Shofer janë të kontraktuar me kontratë pune, respektivisht për mjetet e marra me qera, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.)

- **1 (një) elektrikist** të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të liçencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.
- **5 (pesë) hidraulik** të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të liçencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.
- **5 (pesë) karpentier** të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të liçencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.
- **2 (dy) saldator** të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të liçencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.
- **2 (dy) montator** të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të liçencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.
- **2 (dy) mekanik** të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të liçencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.
- **2 (dy) punonjës asfalti** të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të liçencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.
- **2 (dy) betonues** të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të liçencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë

elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Tekniku i ndërtimit** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Manovratorët** janë të nevojshëm për manovrimin e mjeteve të rënda që do të përdoren gjatë zbatimit të punimeve. Bazuar në orët e punës që dalin nga zbërthimi zë më zë i preventivit dhe afatit të punimeve rezultojnë të nevojshëm 4 manovratorë.
- **Shoferët** janë të nevojshëm për manovrimin e mjeteve (kamionave) që do të përdoren gjatë zbatimit të punimeve. Bazuar në orët e punës që dalin nga zbërthimi zë më zë i preventivit, afatit të punimeve si dhe sasisë së materialeve që do të transportohen rezultojnë të nevojshëm 4 shoferë.
- **Punonjes hidraulik** prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.
- **Punonjes elektrikist** prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.
- **Saldator** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me eficensë të punimeve të saldimit referuar zërave të Konstruksioneve metalike ne veper.
- **Montator** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me eficensë të punimeve të montimit referuar zërave përkatës.
- **Mekanik** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me eficensë të punimeve mekanike referuar zërave përkatës.
- **Punonjes asfalti** prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.
- **Karpentier** referuar preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me eficensë te punimeve te karpentierise.
- **Betonues** bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit dhe të volumeve që do të kryhen referuar punimeve te betonit ne objekt.

Kategorizimi i profesionit të punonjësve është bërë bazuar në kodet e përcaktuara në VKM 514 datë 15.09.2017, si më poshtë:

3119.15 Teknik ndërtimi (Grup njësi “Teknikë të shkencës së fizikë dhe inxhinierisë të pa klasifikuar diku tjetër” Kodi i profesionit: 3119) Funksionet kryesore: Teknikët e këtij grupi kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës: a) Mbledhin të dhëna dhe japin mbështetje teknike për të kontribuar në përdorimin sa më efikas, të sigurtë dhe ekonomik të burimeve njerëzore dhe materiale, por edhe të pajisjeve. b) Kontribuojnë me anë të komenteve dhe sugjerimeve për vendosjen dhe planimetrinë e linjës së punës duke pasur parasysh procesin e caktuar që zhvillohet. c) Zbatojnë metoda pune dhe një seri veprimesh për të kryer detyrat e caktuara. d) Mbikëqyrin ecurinë dhe vazhdimësinë e metodave dhe planeve të punës së përcaktuar. e) Ndihmojnë në identifikimin e kërcënimeve për sigurinë dhe prezantojnë procedurat dhe pajisjet e sigurisë tek punonjësit e tjerë. f) Manovrojnë pajisje të ndryshme që prodhojnë produkte dhe nënprodukte të produkteve të para. g) Montojnë pajisjet dhe materialet sipas procedurës së përcaktuar për të prodhuar produktin final. h) Kryejnë teste laboratorike dhe shënojnë rezultatet në regjistrat përkatës. i) Përgatisin preventivë të detajuar të sasive dhe kostove të materialeve dhe punës së nevojshme për kryerjen e punës me saktësi dhe efikasitet. j) Monitorojnë aspektet teknike, rregullatore dhe ato të sigurisë së ndërtimit, instalimit, manovrimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të materialeve dhe pajisjeve. k) Ndihmojnë në dizenjimin dhe planifikimin e materialeve, metodave dhe planeve të punës. l) Respektojnë politikat e brendshme të punës dhe procedurat e hartuara nga Institucioni. m) Zbatojnë kodin e etikës të miratuar nga drejtuesit. n) Zbatojnë rregullat e sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit. o) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Kërkesat për punësim: a. Zakonisht kërkohet të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale; në disa raste një diplomë nga një shkollë e mesme e përgjithshme dhe eksperiencë pune disa vjeçare është gjithashtu e vlefshme.

Manovratorët (drejtuesit e makinerive të rënda eksavatorit/ fadromës,) dhe shoferat e kamionit (Grupi-njësi (Profesioni) “Shoferë të makinave të rënda dhe kamionëve” Kodi i profesionit: 8332)

8332.14 Shofer kamioni

Kërkesat për punësim a. Të jetë e/i pajisur me leje drejtimi të nivelit përkatës. b. Zakonisht kërkohet përfundimi i një shkolle profesionale në këtë fushë. c. Të ketë kryer një kurs formimi profesional për këtë profesion. d. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur për çdo zë punimesh, bazuar në afatin përkatës të grafikut të punimeve.

Vendosja e këtyre kritereve për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zërat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është përllogaritur si dhe mjeteve të kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

Kërkesa që punonjësit të jenë me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) të lëshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë është bërë bazuar duke vlerësuar se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve nëpërmjet zbatimit të masave të nevojshme.

Kërkesa për dëshmitë e drejtuesve të mjeteve të rënda bazohet në Urdhërin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për

kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre **1 (një) punonjës** i cili të plotësojë kërkesat dhe të disponojë çertifikatën si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”**, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Minimuni **1 (një) inxhinier** që përmbush kriteret për të qenë **“Përgjegjës për dëmet në mjedis”**.

Minimuni **1 (një) punonjës** specialist si **Ekspert zjarrëfikës** në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, të çertifikuar nga Drejtoria e MZSH-së.

Minimuni **1 (një) punonjës** që përmbush kriteret për të qenë **“Ekspert për Ndihmën e parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave”**.

Minimuni **1 (një) punonjës** që përmbush kriteret për të qenë **“Përgjegjës për Sigurinë dhe Kontrollin e Cilësisë”**.

Shenim: Për specialistin “Ekspert Zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, Operatori Ekonomik mund ta disponojë edhe të kontraktuar me kontratë pune/shërbimi për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë Diplomë / Certifikatat e cituara më sipër.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën e punës,
- diplomën/certifikatën përkatëse.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi : Kërkesa e shkronjës d) të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht :

Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores

“Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën e nevojshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë licencën – Kodi III.2.B - *“Për grumbullim, transportim dhe depozitim i dherave dhe mbetjeve inerte”*, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), të vlefshme. *Mbështetur në ligjin Nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (ndryshuar me Ligjin Nr. 10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”)*.

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën e nevojshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë licencën Kodi III.2.A *“Për shërbime ekspertize dhe / ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”*, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), të vlefshme. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas tabelës së ndarjes së punimeve të marra përsiper dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencë ose të paraqesë kontratë shërbimi me subjekte të licencuara për Leje mjedisore e tipit “C” për “Magazinim dhe/ose trajtim i mbetjeve të tjera të ujerave të zeza urbane” (lëshuar nga QKB), kodi III.1.A.

Argumentimi: Duke qënë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve dhe kryerjen e transportit të tyre, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 *“Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 *“Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”* **ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të licencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B)** sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 *“Për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”*, nga institucioni kompetent që lëshon këto licenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 *“Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”*. Kërkesa e mësipërme për Kodi III.2.B, është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 dhe 4, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”*, nenin 39, pika 6/a, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar. Gjithashtu, meqense kemi te bëjmë me punime te realizuara ne hapesire rrugore, ku eshte e nevojshme kujdesi i vecante ndaj mjedisit eshte kerkuar licenca Kodi III.2.A *“Për shërbime ekspertize dhe / ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”*, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), të vlefshme.

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencë ose të paraqese kontrate shërbimi me subjekte të licencuara për Leje mjedisore e tipit “C” për “Magazinim dhe/ose trajtim i mbetjeve të tjera të ujërave të zeza urbane” (lëshuar nga QKB), kodi III.1.A. Meqenëse punimet do të realizohen në thellesi deri në 4 m është e nevojshme që subjektet të jenë të licencuara ose të kenë kontraktuar subjekte të cilat janë të pajisura me licence kodi III.1.A.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë një numër mesatar prej jo më pak se **60 (gjashtëdhjetë)** punonjës të siguruar për 3 (tre) mujin e fundit (duke përfshirë edhe stafin teknik të sipërcituar). Për t’u vërtetuar këtë duhet të paraqesë :

- Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore/ose Tatimore.
- Listpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar më sipër dhe të jenë të konfirmuara nga Dega Rajonale Tatimore ku është i regjistruar subjekti.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar si dhe referuar grafikut të punimeve të hartuar nga projektuesi, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Numri i punonjësve është vendosur bazuar në sasinë e çdo zëri punimesh në preventiv dhe në natyrën e objektit të kësaj kontrate, pasi nga zbërthimi i zërave të preventivit dhe afati i parashikuar i punimeve **orë pune punëtori dhe orë pune makineri**, për të cilat nevojiten 50 punonjës, ku përfshirë dhe stafin teknik nevojiten në total të paktën **60 (gjashtëdhjetë) punonjës**.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës dhe transportues ≥ 20 ton	copë 1	Në pronësi ose me qira
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës dhe transportues 10-20 ton	copë 1	Në pronësi ose me qira
Kamionçina me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	copë 2	Në pronësi ose me qira

Makeri për skarifikim	copë 1	Në pronësi ose me qira
Grejder	copë 1	Në pronësi ose me qira
Rul (kompresor) me vibrim	copë 1	Në pronësi ose me qira
Autobot	copë 1	Në pronësi ose me qira
Autobitumatriçe	copë 1	Në pronësi ose me qira
Parangrohes 3000 liter	copë 1	Në pronësi ose me qira
Kaldaje bitumi 10000 litër	copë 1	Në pronësi ose me qira
Rul thike	copë 1	Në pronësi ose me qira
Eskavator 2 m3	copë 1	Në pronësi ose me qira
Vinc ekskavator	copë 1	Në pronësi ose me qira
Ekskavator batipal 1.8 ton	copë 1	Në pronësi ose me qira
Autovinc deri 5 ton	copë 1	Në pronësi ose me qira
Ekskavator krahgjatë	copë 1	Në pronësi ose me qira
Ekskavator me goma	copë 1	Në pronësi ose me qira
Minieskavator / minifadrome	copë 1	Në pronësi ose me qira
Ekskavator me paisje shtesë për ngulje palankola	copë 1	Në pronësi ose me qira
Palankola metalike	50 ton	Në pronësi ose me qira
Aparatura për testimin e ngjeshmërisë së materialit me metode me goditje (me pjate)	copë 1	Në pronësi ose me qira
Fabrike betoni	copë 1	Në pronësi ose me qira, kontrate furnizimi
Freze asfalti	copë 1	Në pronësi ose me qira
Rrul gome - hekur mbi 15 ton	copë 1	Në pronësi ose me qira
Gjenerator		
Tokmak	copë 1	Në pronësi ose me qira
Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve të domosdoshme në kantier		
Kokore	copë 60	Në pronësi ose me qira
Jeleke	copë 60	Në pronësi ose me qira
Tabela sinjalizuese rrugore	copë 20	Në pronësi ose me qira
Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra	copë 5	Në pronësi ose me qira
Prozhektorë ndriçimi	copë 5	Në pronësi ose me qira
Kulle ndricimi	copë 1	Në pronësi ose me qira
Kuti ndihme e shpejtë	copë 2	Në pronësi ose me qira

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës si më poshtë ;

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet:
 - a) Dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
 - b) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
 - c) Çertifikatën e vlefshmërisë së kontrollit teknik (SGS)
 - d) Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
 - e) Liçencë transporti;
 - f) Çertifikatë transporti nga njësia vendore;

- g) Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij
 - Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë me qira, duhet të paraqitet:
 - a) Kontrata e qerasë
 - b) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
 - c) Certifikatën e vlefshmërisë së kontrollit teknik (SGS)
 - d) Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
 - e) Liçencë transporti (për transport mallrash për të tretë dhe me qera);
 - f) Certifikatë transporti nga njësia vendore;
 - g) Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë apo marrjen me qira të tyre (fatura tatimore blerje, akte ç'doganimi, kontrata noteriale për marrjen me qira)
- Për mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë vendodhjen e mjeteve, me qëllim verifikimi në çdo kohë prej Autoritetit Kontraktor deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës së makinerive.
- Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak s'kualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.
- Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin".

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standartave, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentat konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si me poshtë:

- ISO 9001:2015 **Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë**
- ISO 14001:2015 **Sistemet e Menaxhimit Mjedisor**
- ISO 45001:2023 **Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë**
- ISO 39001:2012 **Për menaxhimin e sigurisë në trafikun rrugor**

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë. Certifikatat e lëshuara nga organizma të pa akredituara do të konsiderohen kusht skualifikimi.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e

kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001:2023 është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001:2023 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 39001:2012 *(Për menaxhimin e sigurisë në trafikun rrugor)* ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë sigurinë në trafikun rrugor. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi sigurinë në trafikun rrugor. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 39001:2012 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në trafikun rrugor gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën e sigurisë duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e sigurisë në trafikun rrugor.

2.4.2 Afati i kryerjes së punimeve

Afati i kryerjes së punimeve është 12 (dymbëdhjetë) muaj sipas Grafikut të Punimeve të publikuar ne SPE

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë deklaratën **ku të shprehet se është dakort me menyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të perfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, (Në rast të shpalljes fitues).**

Do të organizohet një vizitë në kantier 3 ditë para zhvillimit të tenderit në orën 12:00 prane Autoritetit Kontraktor për tu njohur me terrenin ku do të kryhen punimet dhe me projektin e zbatimit. Në perfundim të vizites, pjesëmarrësit do të pajisen me vertetim. (mosparaqitja është kusht skualifikimi).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 79 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024), Nenin 39, pika 3 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **deklaratën** ku të shprehet se është dakord me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës dhe shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe materialeve, bazuar në VKM-në të VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim.

Shënim: Për çdo emërtim marke apo cilësie të shënuar në preventivin e punimeve do të pranohet edhe ekuivalenti i tij.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Njësia përgjegjëse ka hartuar/konfirmuar specifikimet teknike, ku janë shprehur qartë kërkesat AK për realizimin e kontratës.

Njesia pergjegjese ne specifikimet teknike argumenton se nuk ka përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Referuar projektit dhe preventivit, si dhe në bazë të llogaritjeve nga specialisti i fushës janë përcaktuar kriteret e mësipërme. Cdo kriter tjetër i vendosur në DST nuk është përgjegjësi e imja si Anëtare e Njesisë së Prokurimit.

Argumentimi i specifikimeve teknike : Specifikimet teknike jane hartuar nga specialistët e fushës, bashkëngjitur DST në SPE.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës dhe shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe materialeve, bazuar në VKM-në të VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim

NJËSIA E PROKURIMIT